



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E MIRËADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, ASETIVE DHE  
SHËRBIMEVE

Nr. 1866 prot.

Tiranë, më 09.03. 2020

URDHËR

Nr. 90, datë 09.3. 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR.739, DATË 05.11.2018 “PËR  
PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE AFATIT TË DORËZIMIT TË  
DOKUMENTACIONIT, SI DHE PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PËR  
POZICIONIN VAKANT TË OFICERIT TË SIGURISË”**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Pika 3 e Urdhrit nr.739, datë 05.11.2018 “Për përcaktimin e mënyrës dhe afatit të dorëzimit të dokumentacionit, si dhe për procedurat e konkurrimit për pozicionin vakant të oficerit të sigurisë”, të ndryshojë si më poshtë:

*“3. Paraqitja e dokumentacionit të kërkuar të bëhet në një nga mënyrat e përcaktuara në shpalljen bashkëlidhur këtij urdhri, brenda datës **20.03.2020**.”*

2. Pika 4 e Urdhrit nr. 739, datë 05.11.2018, të ndryshojë si më poshtë:

*“4. Verifikimi paraprak i dokumentacionit do të kryhet nga MASR nëpërmjet Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike” në datën **23.03.2020**”.*

3. Pika 5 e Urdhrit nr. 739, datë 05.11.2018, të ndryshojë si më poshtë:

*“5. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazat e mëtejshme do të shpallet në ueb-in (web) zyrtar të MASR-së dhe çdo kandidat i skualifikuar do të njoftohet me postë elektronike, brenda datës **23.03.2020**”.*

4. Pika 6 e Urdhrit nr. 739, datë 05.11.2018, të ndryshojë si më poshtë:

*“6. MASR pas publikimit të kandidatëve të skualifikuar, do të pranojë ankimimet nga data **24-25.03.2020**. Ankimimi do të bëhet në një nga mënyrat e përcaktuara në shpalljen bashkëlidhur këtij urdhri.”*

5. Pika 7 e Urdhrit nr. 739, datë 05.11.2018, të ndryshojë si më poshtë:

*“7. Intervista e kandidatëve të kualifikuar do të bëhet nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e përbashkët të MASR dhe MB. Intervista të kryhet sipas formatit të shtojcës 3 dhe kërkesave të përcaktuara në shpalljen bashkëlidhur dhe do të zhvillohet në datat **27.03.2020**.”*

6. Pika 8 e Urdhrit nr. 739, datë 05.11.2018, të ndryshojë si më poshtë:

*“8. Shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar në përfundim të intervistës, do të bëhet brenda datës **30.03.2020** në ueb-in (web) zyrtar të MASR-së.”*

7. Pika 9 e Urdhrit nr.739, datë 05.11.2018, të ndryshojë si më poshtë:

*“9. Lista e kandidatëve të kualifikuar i përcillet Akademisë së Sigurisë për trajnimin mbi sigurinë në shkolla dhe certifikimin e tyre brenda datës **31.03.2020**.”*

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTRI**  
**Besa SHAHINI**

